



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 49 (827853)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 dhjetor 2023



Shqipëria, një strategjike e infrastrukturës në rajon dhe një faktor stabiliteti në Ballkan

» faqe 3

Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në ceremoninë e betimit të kursantëve dhe rekrutëve të rinj

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e betimit të kursantëve të SIB dhe KPO, si dhe të rekrutëve të rinj. Në ceremoninë, e cila u zhvillua në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarit, në Bunavi ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Bardhyl Nuredini, komandanti i QAPU-së, nënkolonel Bujar Fejzo, komandantë, drejtorë drejtorish në SHP, familjarë, etj. Gjeneralmajor Arben Kingji, në përshëndetjen e tij shprehu kënaqësinë e marrjes pjesë në këtë ceremoni, duke e konsideruar atë shumë të veçantë dhe domethënëse në jetën dhe karrierën e çdo ushtaraku. “Ceremonia e betimit ushtarak është një ditë e shënuar dhe me domethënie shumë të madhe për të gjithë ne, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Forcave të Armatosura. Betimi ushtarak përbën momentin më solem, atë të premtimit dhe betimit përpara flamurit kombëtar për besnikëri të përjetshme ndaj Kushtetutës, si dhe për t’i shërbyer me nder e për ta mbrojtur atdheun...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Arben Kingji. Më tej gjatë fjalës së tij, SHSHPFA shprehu vlerësim dhe kënaqësi që programin 10 - javor të Stërvitjes Bazë, i cili u zhvillua njëkohësisht në



Qendrën e Arsimit të Ushtarit, në Bunavi, në Regjimentin e Këmbësorisë së Jugut, në Poshnje si dhe në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, në Vaun e Dejës, e kanë përfunduar me sukses 138 vetë, nga këta 54 kursantë të Kursit të Përgjithshëm të Oficerit dhe 84 rekrutë të rinj, duke synuar zhvillimin dhe forcimin e karakterit,

për të përmbushur trinomin e shenjtë “Nderi-Detyra-Atdheu”.

“Forcat e Armatosura janë në proces të vazhdueshëm transformimi dhe modernizimi në të gjitha nivelet dhe kjo kërkon domosdoshmërinë e hartimit dhe harmonizimit të programeve dhe kurikulave në institucionet arsimore, metodave teorike dhe praktike të



mësimdhënies, në drejtim të përgatitjes së një force të mirë trajnuar, të mirë arsimuar, profesioniste, për t’u përballur me sukses me sfidat në zhvillim në mjedisin e sigurisë...”, - u shpreh gjeneralmajor Arben Kingji.

Në përmbyllje të fjalës së tij, SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji adresoi një falënderim të

veçantë për gjithë personelin e Qendrës së Arsimit të Ushtarit, Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe atij të Veriut, për punën e bërë dhe rezultatet e arritura gjatë gjithë kësaj periudhe të ngjeshur, si dhe u uroi suksese kursantëve dhe rekrutëve të rinj në rrugëtimin e tyre në radhët e Forcave të Armatosura.

Gjeneralmajor Arben Kingji priti komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim zyrtar komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas.

Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneralmajor Kingji, pasi i uroi suksese në detyrën e re, vlerësoi me nota maksimale angazhimin dhe rëndësinë e misionit KFOR, në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon: “Shqipëria do të vijojë të japë kontributin dhe mbështetjen e saj ushtarake në misionin e NATO-s, KFOR. Ne do jemi gjithmonë pro alternativave për gjetjen e zgjidhjeve që në thelb kanë mbrojtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së Kosovës dhe mbetemi mbështetësja më e fortë e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, mbështesim dialogun Kosovë - Serbi, si një ndër hapat më të rëndësishëm që do i hapë rrugë zgjidhjeve të mëtejshme të problematikave në funksion të integritimit në strukturat ndërkombëtare”.

Gjeneralmajor Ulutas nga ana e tij u shpreh se: “Shqipëria me kontributin



e saj politik dhe ushtarak vijon të jetë një nga mbështetëset kryesore të misionit të NATO-s, KFOR dhe pro dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, dialog ky që do t’i hapë rrugë zgjidhjeve të problematikave në funksion të integritimit në strukturat ndërkombëtare si dhe në shërbim të paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.”

Në përfundim të takimit zyrtar, të

dy autoritetet reciprokisht falënderuan përkushtimin dhe bashkëpunimin e frytshëm në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas, gjatë vizitës së tij në vendin tonë u prit në takim zyrtar edhe nga presidenti i RSH, sh.t. z. Bajram Begaj dhe ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi.

Gjeneralmajor Arben Kingji priti ambasadorin e Spanjës Alvaro Renedo Zalba



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim të veçantë ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës, Alvaro Renedo Zalba, i cili shoqërohej nga atasheu ushtarak spanjoll në vendin tonë, kapiten i rangut I Frederico Garsia Castro.

Gjeneralmajor Kingji në fjalën e tij, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, si dhe u shpreh besimplotë në mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në fushën e trajnimit, arsimimit dhe stërvitjes. Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji adresoi një falënderim dhe vlerësim për kontributin e Mbretërisë së Spanjës në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ambasadori Zalba nga ana e tij, falënderoi SHSHPFA për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi me nota pozitive rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor, si promotore e paqes dhe sigurisë në rajon, si dhe shprehu gatishmërinë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve.

Shqipëria, një strategjike e infrastrukturës në rajon dhe një faktor stabiliteti në Ballkan

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në ditën e 33-vjetorit të 'kryengritjes' së rinisë shqiptare, në realizimin e ëndrrës për ta parë Shqipërinë si gjithë Europa, në fjalën e tij përshëndetëse, si pjesë e të rinjve që nuk pranuan nënshtrimin, do të sillte në vëmendje rolin e Forcave të Armatosura, rëndësinë si dhe angazhimin e saj në mbrojtjen e vendit dhe interesave të përbashkëta si dhe transformimin e saj në kapacitete njerëzore të mirë arsimit dhe trajnimit të denjë për udhëtimin e përbashkët për ruajtjen e vlerave njerëzore të aleancës më të madhe, NATO. Në fjalën e tij, ministri Niko Peleshi foli për arritjet dhe vizionin për Shqipërisë si një faktor stabiliteti për Ballkanin Perëndimor. Peleshi nënvizoi se Shqipëria është sot prezente në 8 misione ndërkombëtare dhe po ashtu një strategjike e infrastrukturës së sigurisë në rajon, duke shtuar se Shqipëria sot është në momentin më të mirë historik.

"Shqipëria është pjesë e rajonit të brishtë të Ballkanit Perëndimor. Opinioni publik ka nevojë të dëgjojë ku qëndron Shqipëria në këtë situatë të brishtë. Shqipëria është vend pritës i stërvitjes më të madhe, "Defender Europe". Në janar mbërrin flota e re e helikopterëve, në pranverë flota e dronëve "Bayraktar".

Dy satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2" mbulojnë territorin e Shqipërisë. Shqipëria sot është prezente në 8 misione ndërkombëtare. Krahas punës dhe investimit për përmbushjen e objektivave të kapaciteteve të NATO-s ne gjithashtu do të punojmë për projektet tona. Shtimin e flotës së helikopterëve. Së bashku me aleatët tanë strategjikë do të punojmë për të ndërtuar siguri në Korridorin e 8-të. Edukimi ushtarak do të jetë një komponent i përhershëm.

Ndërkombëtarizimi i edukimit ushtarak për të kontribuar edhe me dije tashmë është një proces më i zhvilluar. Vitin që vjen do të shtojmë forcat në KFOR, Kosovë, por edhe në Bosnje-Hercegovinë", - tha ndër të tjera ministri Niko Peleshi.

Ministri Peleshi deklaroi se kontributi i vendit tonë për paqen në rajon do të shtohet nga viti që vjen me më shumë trupa në KFOR, Kosovë, por edhe në Bosnje-Hercegovinë dhe në Rumani.

Ndër të tjera, ministri u ndal dhe tek edukimi ushtarak, ku deklaroi se kurset e formimit të ushtarakut në siguri dhe mbrojtje kanë filluar të zhvillohen në gjuhën angleze me studentë nga shumë vende të NATO-s. "Edukimi ushtarak do të jetë një komponent i përhershëm i zhvillimit tonë të mbrojtjes vetëm për të siguruar arsimimin e nevojshëm për ushtarakët, por edhe për të kultivuar karakterin dhe ndjenjën e patriotizmit. Ndërkombëtarizimi i edukimit ushtarak për të kontribuar me dije edhe për vendet e rajonit e më gjerë, tashmë ka filluar.

Kurset e formimit të ushtarakut në siguri dhe mbrojtje kanë filluar të zhvillohen në gjuhën angleze me studentë nga shumë vende të NATO-s. Kontributi ynë për paqen në rajon do të shtohet nga viti që vjen me më shumë trupa në KFOR Kosovë, por edhe në Bosnje-Hercegovinë dhe në Rumani. Shqipëria sot është eksportuese e paqes, prezente në 8 misione ndërkombëtare, në KFOR Kosovë, Bosnjë, Irak, Detin Mesdhe, Letoni, etj.", - deklaroi Peleshi.

Më tej ministri Peleshi do të sillte në vëmendje dhe disa nga objektivat e arritura përgjatë vitit 2023 si dhe ato që priten të realizohen në vitin 2024. Ku mes të tjerash renditeshin: Me buxhetin e miratuar, Shqipëria bëhet një nga vendet e para në NATO që përmbush zotimin e Samitit të Well-sit për dedikimin e 2% të PBB në mbrojtje; Modeli më i mirë i edukimit ushtarak i Akademisë Amerikane "West Point", është implementuar duke filluar nga ky vit akademik në AFA; Shqipëria nga ky vit ka komandën e Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG); Në janar të vitit që vjen, Shqipëria bëhet udhëheqëse e Iniciativës Rajonale SHBA - Karta e Adriatikut - A5; Ministeriali i mbrojtjes së Europës Juglindore gjithashtu do të mbahet në Shqipëri në vitin e ardhshëm (SEDM).

KU DUAM TË SHKOJME

• Vizionin e KM për Shqipërinë si "Europa e



Ballkanit" në gjuhën e sigurisë dhe mbrojtjes ne e përkthejmë: Të ndërtojmë një Shqipëri të fortë, çka do të thotë një faktor i fortë stabiliteti për Ballkanin Perëndimor.

• Krahas punës dhe investimit për përmbushjen e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, ne do të punojmë për një qëndrueshmëri kombëtare, për përforcimin e kapaciteteve tona kombëtare të mbrojtjes.

Sipas artikullit të 3-të të Traktatit të NATO-s projektet tona afatmesme dhe afatgjatë parashikojnë ngritjen dhe fuqizimin e: Sistemit të Mbrojtjes Ajrore dhe Mbrojtjes Anti-dron.

• Shtimin e flotës së helikopterëve "Blackhawk".

• Ndërtimin e Portit Ushtarak të Porto Romanos, si një bazë taktike ndihmuese e NATO-s me modelin e Bazës Ajrore të Kuçovës.

• Së bashku me aleatët tanë strategjikë do të punojmë për të ndërtuar siguri përgjatë Korridorit VIII, një korridor europian që lidh Detin e Zi me Detin Adriatik apo thënë ndryshe Adriatikut me krahun lindor të aleancës sonë, krahun më të kërcënuar të NATO-s.

• Edukimi ushtarak do të jetë një komponent

i përhershëm i zhvillimit tonë të mbrojtjes, jo vetëm për të siguruar arsimimin e nevojshëm për ushtarakët, por edhe për të kultivuar karakterin dhe ndjenjën e patriotizmit.

NDËRKOMBËTARIZIMI i edukimit ushtarak për të kontribuar me dije edhe për vendet e rajonit e më gjerë, tashmë ka filluar.

• Kurset e formimit të ushtarakut në siguri dhe mbrojtje kanë filluar të zhvillohen në gjuhën angleze me studentë nga shumë vende të NATO-s.

• Kontributi ynë për paqen në rajon do të shtohet nga viti që vjen me më shumë trupa në KFOR Kosovë, por edhe në Bosnje-Hercegovinë dhe në Rumani.

DINJITETI I USHTARAKUT

• Një mbrojtje e fortë kërkon një trajtim dinjitoz për ushtarakët e FARSH-së.

Rritja prej 40% e pagave për të gjithë ushtarakët i bëri FARSH-të të ngjiten nga niveli i trajtimit më të ulët, drejt niveleve më të larta në rajon, me synimin për të arritur mesataren e vendeve të aleancës.

• Kredi të buta për strehim, një laborator i dedikuar analizash dhe një klinikë dentare e dedikuar për ushtarakët dhe ish-ushtarakët janë

vetëm një pjesë e PAKETËS SOCIALE TË USHTARAKUT.

BASHKËPUNIMI CIVIL USHTARAK

• Ndërkohë që shpresojmë më të mirën, duke u përgatitur për më të keqen, ne punojmë për krahas institucioneve të tjera në rrugën për zhvillim kombëtar.

• MBROJTJA civile, përbashkimi i emergjencave dhe fatkeqësive natyrore, kanë gjithmonë në ballë ushtarakët e shkëlqyer të FARSH-së.

• Kapacitetet tona ushtarake nuk janë asete të fjetura por pjesë integrale e kapaciteteve kombëtare.

Shërbimi satelitor sot vjen në ndihmë të punës së shumë institucioneve të ligj zbatimit dhe zhvillimit.

Flota e dronëve, një kapacitet i ri ushtarak, do të kontribuojë gjithashtu në lehtësimin dhe përmirësimin e shërbimeve të tjera publike, nga rendi e siguria deri te infrastruktura.

Sistemi i mbrojtjes anti-dron do të mbulojë jo vetëm infrastrukturën ushtarake, por edhe atë civile.

Qendra ushtarake operacionale e Mbrojtjes Kibernetike është pjesë e infrastrukturës kombëtare të Sigurisë Kibernetike.

DHE NË FUND 2 FJALË PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË INOVACIONI

• Avancimi teknologjik dixhital galopant po transformon çdo fushë të shoqërisë, natyrisht edhe mbrojtjen.

• Inovacioni nuk është thjesht një MUNDËSI, por është një domosdoshmëri për sistemet tona të mbrojtjes.

• Nuk është një domain i vendeve më të zhvilluara, por më së shumti një shans për të tejkaluar diferencat.

• Ndjaj Shqipëria NUK do të jetë thjesht një ndjekëse në këtë proces.

• Ne kemi hapur Qendrën tonë të Inovacionit, ku do të punojmë për të qenë me hapin e kohës dhe pse jo një lider në rajon në fushën e transformimit teknologjik.

• Shqipëria është sot në momentin më të mirë historik.

• Kjo është Dita e Shqipërisë!

• Dita e shqiptarëve!

• Le të frymëzohemi nga ky moment dhe të punojmë për një të ardhme nga ku brezat do të shohin pas me krenari.

• Në atë të ardhme shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës do të jenë të bashkuar në hapësirën e NATO-s dhe BE-së dhe do të thonë me bindje se jo vetëm ditëm të përballlemi me sfidat por i transformuam ato në ura të reja drejt ribashkimit me Europën.



Në Batalionin e Xhenios u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit XIV EOD

Në mjediset e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIV EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (Enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup – batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, kolonel Aleksandër Pando, zëvendëskomandant i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, familjarët e kontingjentit EOD dhe efektivit të Batalionit të Xhenios.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, i cili shprehu mirënjohje për SHPFA dhe Komandën Mbështetëse për mbështetjen e pakursyer të këtij misioni, si dhe falënderoi kontingjentin për përkushtimin e treguar në stërvitjen paradisllokuere, duke arritur aftësi operacionale për misionin dhe duke u shprehur besimplotë për kryerjen e këtij misioni.

Më pas fjalën përshëndetëse e mbajti drejtori i SHPFA-së, kolonel Aleksandër Pando, i cili shprehu mbështetjen në emër të SHPFA-së si dhe uroi kontingjentin për misionin e radhës.

Në emër të kontingjentit përshëndeti togër Denis Keshi, i cili, pasi falënderoi komandantin e Batalionit për mbështetjen e vazhdueshme gjatë stërvitjes paradisllokuere, u shpreh se kontingjenti do të përfaqësojë me dinjitet dhe krenari flamurin tonë kombëtar në Letoni.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin XIV EOD, dhe u mbyll me një foto të përbashkët.



Gjeneral brigade Ylli Pulaj priti atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti.

Gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin shumë të mirë mes vendeve për zhvillimin e kurseve institucionale nga oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvillon analizën e punës vjetore

Në mjediset e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë u zhvillua analiza vjetore mbi punën e realizuar nga kjo strukturë gjatë vitit 2023. Të pranishëm në këtë analizë ishin zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kolonel Aleksandër Pando, zëvendësdrejtori i drejtorisë së personelit në SHPFA si dhe drejtues të strukturave kryesore të Kolegjit.

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, pasi falënderoi zëvendëshefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu për prezencën e saj në këtë analizë vjetore së bashku me stafin, vijoi me prezantimin e analizës, duke u ndalur në arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë vitit 2023 si dhe punën e bërë për realizimin e këtyre detyrave si: plotësimi i strukturës organike me pedagogë që kanë aftësi të spikatura, ndryshimi i bazës ligjore, me qëllim lehtësimin e ndërveprimit me Kolegje dhe Institucione të tjera simotra brenda dhe jashtë vendit për shkëmbimin e lektorëve, programeve dhe kurrikulave, zhvillimi i programit mësimor të rishikuar me kurset institucionale për Vitin Akademik 2023-2024, duke rritur modulet në gjuhën angleze, praktikën për përgatitjen e KLSM-14 si dhe puna për përgatitjen e programeve të mbrojtjes 2025-2030 për Kolegjin. Më pas gjeneral brigade Ylli Pulaj u shpreh se Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) do të angazhohet për realizimin e të gjitha detyrave për përfundimin me sukses të vitit 2023



dhe fillimin e vitit 2024 me objektiva qartësisht të fokusuar në misionin e tij.

Në fjalën e saj zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu falënderoi për prezantimin gjeneral Pulaj dhe stafin për punën 1-vjeçare, duke cituar se: “Sot Ju bëtë bilancin e punës tuaj vjetore, ku me të drejtë shpalosët disa nga arritjet e institucionit tuaj të kualifikimit të oficerëve. Para së gjithash unë dua të falënderoj gjithë stafin tuaj për punën e mrekullueshme të bërë për kualifikimin e oficerëve të niveleve të ndryshme. Dua gjithashtu të falënderoj drejtuesit e kolegjit, kolonel Hajdarasin dhe tani gjeneral Pulaj, i cili i ka dhënë një impuls të ri punës së këtij institucioni të rëndësishëm arsimor ushtarak. Kolegji me strukturën e fundit të FA-së, i shkëputur nga AFA si institucion më vete në vartësi direkt të SHPFA, mundëson kualifikimin e oficerëve të niveleve të larta, si drejtues

të ardhshëm të Forcave të Armatosura, por edhe ushtarakë të FSK-së, të cilët prej vitesh janë bërë pjesë e kurseve tona. Unë u njoha edhe me arritjet tuaja për të cilat gjej rastin t’ju falënderoj të gjithëve si staf dhe në mënyrë të veçantë stafin e pedagogëve për punën e kryer, duke mbyllur me sukses kurset si: KTHOSH, KKSHP, KLO dhe KLSM-13. Parë në këtë kontekst, fokusi i punës suaj do të jetë ngritja dhe zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor sipas standardeve të NATO-s, bazuar në parimet e profesionalizmit, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura”.

Në këtë panoramë të punës njëvjeçare, u përmendën gjithashtu edhe disa vështirësi të hasura gjatë realizimit të procesit mësimor si infrastruktura dixhitale dhe hidrosanitare, për të cilat u diskutua edhe për gjetjen e opsioneve më të mundshme për zgjidhjen e tyre në të ardhmen e afërt.



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia pret atasheun e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie atasheun e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Timothy Wight Boycott.

Komandanti i FT-së, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer mes Forcës Tokësore dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, kontributin që ato kanë dhënë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të FT-së në trajnim, stërvitje dhe pajisje.

Më pas për atasheun u prezantua një brifing i shkurtër mbi strukturën e re të organizimit të Forcës Tokësore, misionin, detyrat e saj, kapacitetet operacionale, kontributin e FT-së në misione në përbërje të NATO-s etj.

Në këtë takim, vëmendje e veçantë iu kushtua planit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes për vitet 2024 - 2025.

Atasheu, pasi falënderoi komandantin dhe të pranishmit për pritjen e ngrohtë, theksoi se bashkëpunimi midis dy forcave tokësore tona do të forcohet akoma më shumë për të qenë sa më ndërveprues në përgjigje të situatave kritike që po kalon rajoni ynë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Teksa jeni duke luftuar për të thënë “jo” në punë dhe në vend të kësaj ndjeni nevojën për të ndihmuar vazhdimisht kolegët, mund të jeni duke kompromentuar suksesin tuaj.

Sado e vrazhdë që tingëllon, të qenit i ndërgjegjshëm dhe i mirë me të tjerët mund të ketë një kosto për sa i përket suksesit në karrierë. Njerëzit që bien dakord më lehtë kanë një tipar personaliteti të karakterizuar nga dhembshuria, miqësia, mirësjellja dhe ndjeshmëria. Njerëzit me këtë tipar personaliteti përshkruhen si “të këndshëm”; ata priren të bëjnë miq të mirë, janë dëgjues të mirë dhe kolegë të mirë.

Punonjësit që janë të mirë me të tjerët kanë të ardhura më të ulëta se njerëzit “e papëlqyeshëm” nga stafi. Ata gjithashtu priren të kenë status më të ulët profesional (për shembull, ata marrin më pak avancime). Të qenit shumë i mirë mund të jetë gjithashtu një problem për ‘drejtuesit’, të cilët shpesh kanë nevojë të marrin vendime të vështira dhe të japin lajme të këqija në mënyrë që punët të kryhen.

Njerëzit e këndshëm ka të ngjarë të tërhiqen nga profesionet “sociale” që janë emocionalisht kërkuese.

A duhet të jemi vazhdimisht ‘të mirë’?

Duket se ka dy arsye pse njerëzit e këndshëm pësojnë pengesa në karrierë. Njerëzit ‘e mirë’ mund të sakrifikojnë suksesin e tyre në procesin e kënaqësisë së të tjerëve. Ata kanë më pak gjasa të negociojnë në mënyrë agresive pagën e tyre dhe kanë më shumë gjasa të jenë pasivë në situata konflikti.


Nga ana tjetër, njerëzit që janë të pakënaqur, janë më të fokusuar dhe konkurrues. Ata nuk lejojnë që dhembshuria e tyre për të tjerët të pengojë qëllimet e tyre. Fatkeqësisht ekzistojnë një numër i konsiderueshëm njerëzish të tillë, që formimi i tyre bazik mungon. Njerëzit me këtë lloj personaliteti janë gjithashtu të lartë në atë që njihet si “treshe e errët” e narcizmit, psikopatisë dhe makiavelizmit, të cilat gjithashtu kohët e fundit janë lidhur me të ardhura më të larta. Individët me këto tipare e veçanërisht me narcizëm, kërkojnë në mënyrë aktive prestigj, synojnë punë të nivelit të lartë dhe ua bëjnë të ditura arritjet e tyre atyre që i rrethojnë. Ndërkohë, njerëzit më të sjellshëm priren të jenë modestë dhe nuk shprehin mburrjen për arritjet e tyre.

Përfitimet e të qenit i mirë

Megjithëse kjo mund të ndikojë në avancimin në karrierë, të qenit njeri i sjellshëm ka përfitimet në vendin e punës. Për shembull, njerëzit e sjellshëm kanë më pak gjasa të jenë viktima të ngacmimit. Ata gjithashtu priren të performojnë mirë në punët që kërkojnë ndërveprime ndërpersonale si shërbimi ndaj klientit, dhe kanë raporte të mira me kolegët në ekip.

Njerëzit e tillë, janë bashkëpunëtorët më të mirë, pasi kanë disa lloj karakteristikash që mund të kontribuojnë në kulturën pozitive organizative. Por, njerëzit e tillë empatikë janë

“Nuk ka gjë më të frikshme se injoranca në veprim”



● Sado e vrazhdë që tingëllon, të qenit i ndërgjegjshëm dhe i mirë me të tjerët mund të ketë një kosto për sa i përket suksesit në karrierë. Njerëzit që bien dakord më lehtë kanë një tipar personaliteti të karakterizuar nga dhembshuria, miqësia, mirësjellja dhe ndjeshmëria. Njerëzit me këtë tipar personaliteti përshkruhen si “të këndshëm”; ata priren të bëjnë miq të mirë, janë dëgjues të mirë dhe kolegë të mirë.

të prirur të angazhohen në profesione që kërkojnë emocione, ata priren të jenë më elastikë se të tjerët në këto profesione. Kjo është për shkak se krijojnë marrëdhënie pozitive me kolegët dhe pacientët, gjë që ndoshta zbut sfidat që kanë këto profesione. Të qenit person i sjellshëm dhe që bie lehtë dakord mund të rrisë suksesin në karrierë, kur kombinohet me disa tipare të tjera, siç është ajo e të qenit i ndërgjegjshëm.

Çfarë duhet të bëni nëse mendoni se jeni shumë i sjellshëm në të gjitha situatat

Ka disa gjëra që njerëzit mund të bëjnë nëse mendojnë se sjellja e tyre tejet e mirë po e pengon suksesin e tyre në punë. Punonjësit e ‘këndshëm’ mund ta përdorin natyrën e tyre të mirë në mënyrë më strategjike, duke vazhduar të ndihmojnë të tjerët, por duke mos hezitur të kërkojnë favore në këmbim.

Mund të mbetesh një koleg i mirë aty ku është e mundur, por jo të sakrifikosh punën për të ndihmuar të tjerët. Njerëzit e tillë zakonisht janë shumë modestë, një këshillë: mos e mohoj suksesin dhe punën tënde dhe mos ua atribuoj vazhdimisht atë të tjerëve. Jini të vetëdijshëm për

vlerat tuaja dhe fokusoni në qëllimet që ju çojnë në avancimin tuaj!

Dikush edhe mund të thotë se elementët injorantë janë prezentë kurdoherë në shoqëri, pasi e gjithë shoqëria nuk mund të jetë me të njëjtin nivel. Natyrisht, kjo është e pranueshme dhe e pamohueshme, por mendoj se e keqja e reflektimit të kësaj dukurie te ne ka të veçantat e saj. Së pari, prania e tyre është në përmasa të ndjeshme. Së dyti, të tillë elementë po shfaqen edhe në poste e pozicione drejtuese.

Po cilat janë të këqijat që po na sjell prania e kësaj mase elementësh injorantë?

Po t’i ndjekim me vëmendje zhvillimet e kohës dhe dukuritë kriminale që përjetojmë, mendoj se disa prej këtyre dukurive janë rrjedhojë edhe nga prania e këtyre elementëve. Jo të pakta janë rastet që aktorë të kryerjes së dukurive kriminale apo të akteve të tjera të shëmtuara dhe jashtë normave njerëzore kanë qenë elementë nga masa e injorancës së përjetuar. Gjithashtu, prezenca e këtyre elementëve në jetën e përditshme reflekton në fjalorin banal që përdorin gjatë komunikimit, të folurit me zë të lartë në rrugë e mjedise sociale,

në lëvizjen e makinave që kanë në përdorim, duke shkelur normat dhe rregullat e qarkullimit, që pa dyshim tërheqin vëmendjen e njerëzve e të tjera dukuri të papranueshme. Konflikte shqetësuese në raportet me të tjerët, deri në akte të rënda kriminale, si rrjedhojë e mungesës së formimit dhe nivelit kulturor, e ndjenjës së madhështisë dhe e superioritetit ndaj të tjerëve. Të gjithë jemi dëshmitarë edhe për këtë realitet nisur nga zhvillimet e ndodhura.

Prania e elementëve injorantë edhe në poste drejtuese për arsye të rrethanave të ndryshme dhe zhvillimeve të kohës, po prezanton nga ata mënyra drejtimi me gjuhën e dhunës, arrogancës dhe prepotencës, duke shfrytëzuar pozicionin dhe pushtetin që kanë, dhe jo me gjuhën e profesionalizmit dhe të arsyes. Pa dyshim, prania e tyre me të tilla praktika po pengon ndjeshëm edhe mbarëvajtjen e punës aty ku punojnë dhe drejtojnë.

Së fundi dua të nënvizoj se prania e elementëve injorantë me pasojat që po na sjellin në jetën e përditshme, duhet parë si një shqetësim dhe problem serioz për të gjithë shoqërinë tonë, për ta kufizuar dhe parandaluar prezencën e tyre,

Ismet Bellova, legjenda e mikrofonit sportiv shqiptar, profesori model në një dekadë në Shkollën Ushtarake "Skënderbej"

Ismet Bellova, mjeshtri i radio-kronikës dhe gazetarisë sportive, komentatori me zërin brilant që për gati gjashtë dekada përcolli në shtëpitë dhe hapësirat mbarë shqiptare emocionet e jashtëzakonshme të sportit e në veçanti futbollit.

Në trashëgiminë e fondit të artë të radios shqiptare, transmetimet e klasit të lartë të Profesor Bellovës, zënë një vend të merituar, aq të vlefshme për brezat e rinj të gazetarëve sportivë. Ashtu sikundër me të drejtë vlerësohet edhe kontributi i tij i spikatur në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe Klubin Sportiv "Partizani", në edukimin dhe përgatitjen e shumë talenteve sportive.

Ismet Bellova, legjenda e papërsëritshme e mikrofonit sportiv, mësuesi pasionant i skënderbegasve e qindra të rinjve në mbarë vendin që ishin të apasionuar e arritën rezultate në sportin shqiptar, u lind më 1 qershor të vitit 1934...Ai ishte mjeshtër i mikrofonit dhe mik i shtrenjtë për këdo që mbështetej tek ai, profesor Bellova është shprehur se "Anton Mazreku u përket atyre figurave të shquara të kulturës fizike dhe sporteve tona, që e kanë filluar jetën e tyre me sportin qysh në moshë të njomë, në fëmijëri, i kanë dhënë rininë sportit dhe e kanë mbyllur jetën e tyre po me sportin". Dhe sikur Plutarku t'i kishte njohur këta dy viganë inteligjentë të lëvizjes tonë sportive, padyshim që do t'i kishte shtuar veprës së tij "Jetët paralele" edhe atë të këtyre dy njerëzve me aq vlera dhe aq të ngjashëm. Madje, do të shtoja se kjo ngjashmëri arrin deri tek kultura e tyre e lartë letrare. Dhe ashtu sikurse vëren i ndjeri dhe i dituri Jup Kastrati për Antonin, duke e quajtur atë një poet të vërtetë, po kaq poet në prozën e tij paraqitet në nektarin që nxjerr nga goja edhe Ismet Bellova, i cili ka ditur të qëndisë aq bukur me metafora, krahasime dhe figura letrare në të gjitha transmetimet në mikrofon apo në artikujt e pafund dhe librat që ai ka shkruar.

Profesor Ismeti, bashkoi në një, sportin me artin, duke i dhënë atij rëndësinë që i jepnin grekët e vjetër pas vitit 581 para erës së re, Lojërave Olimpikë, ku veç garave sportive zhvilloheshin edhe ato muzikore.

Kushdo që e ka dëgjuar, vështirë të mos jetë drithëruar nga vibrimet melodioze të zërit bellovan, vështirë të mos jetë emocionuar deri në përlojtje dhe vështirë të mos i jetë rritur adrenalina e krenarisë dhe atdhedashurisë.

"Mësuesi i Popullit", "Nderi i Sportit Shqiptar", "Urdhri Olimpik", Urdhri i Artë "Naim Frashëri", Urdhri "Naim Frashëri" i klasit të parë, Urdhri i Punës i klasit të parë, fitues i disa çmimeve, deri "Mirënjohja e Tiranës" etj., flasin qartë për personalitetin madhor të Ismet Bellovës. Por rruga për të mbërritur këto maja nuk ka qenë aspak e lehtë. Fillimisht, mësues në gjimnazin "Qemal Stafa" në Tiranë e më vonë, duke qenë fare i ri në moshë, caktohet kryetar i komitetit të fizkulturës dhe sporteve në Qarkun e Dibrës, ku me aftësitë dhe seriozitetin e tij u bë prekursor i mobilizimit për kalimin e mungesave dhe vështirësive të jashtëzakonshme, dhe ku ai la gjurmë të pashlyeshme. Më pas, emërohet mësues për një dekadë në shkollën e mesme të lavdishme "Skënderbej", për të vazhduar në një tjetër shkollë "Politeknikumin 7 Nëntori", me aq tradita edhe në sporte, ku punoi për dymbëdhjetë vjet të tjera. Kjo ka qenë dhe periudha më shkëlqimtare e gjithë karrierës së tij ose apogjeu i tij pedagogjik, pasi është ashtu sikurse vëren Artur Shopenhaueri se "sa më fisnike të jetë puna, aq më e madhe do të jetë kënaqësia". Tani, ai kishte eksperiencën e vyer të Dibrës, të Korçës, ku kreu shërbimin ushtarak dhe Elbasanit, duke organizuar mjaft mirë punën për paraqitjen e ekipeve në spartakiadat që zhvilloheshin, por edhe atë të drejtimit të ekipit të atletikës së sport-klubit "Partizani", ku arriti të caktohet edhe krye trajner i ekipeve të atletikës dhe që u kurorëzua me shumë e shumë rekorde dhe fitimin e kupave të kampionit. Në fillimin e viteve '60, Ismeti, kishte fituar autoritetin e një njeriu shumë të dashur, të aftë dhe punëtori të palodhur dhe fjala e tij dëgjohej me të njëjtin respekt si nga nxënësit, ashtu dhe nga kolegët apo eporët e asaj shkolle. ky autoritet nuk e largonte aspak, përkundrazi, ai dinte të fitonte zemrat dhe të futej në botën e brendshme. Duke e ndjerë veten krejtësisht të shpenguar në marrëdhënie me nxënësit, njeri prej tyre tregon: "Mbah mend se njëherë, kur nisëm të flasim për teoricienët pararendës të marksizmit, na tha se ky François-Noël Babeuf-i juaj të gjithë doktrinën babuviste, mund ta ketë ngritur mbi një kështjellë rëre, por diçka, që ju begsat duhet ta dini mirë, e ka



“ ISMET BELLOVA, LEGJENDA E PAPËRSËRITSHME E MIKROFONIT SPORTIV, MËSUESI PASIONANT I SKËNDERBEGASVE E QINDRA TË RINJVE NË MBARË VENDIN QË ISHIN TË APASIONUAR E ARRITËN REZULTATE NË SPORTIN SHQIPTAR, U LIND MË 1 QERSHOR TË VITIT 1934...AI ISHTE MJESHTËR I MIKROFONIT DHE MIK I SHTRENJTË PËR KËDO QË MBËSHTETEJ TEK AI, PROFESOR BELLOVA ËSHTË SHPREHUR SE "ANTON MAZREKU U PËRKET ATYRE FIGURAVE TË SHQUARA TË KULTURËS FIZIKE DHE SPORTEVE TONA, QË E KANË FILLUAR JETËN E TYRE ME SPORTIN QYSH NË MOSHË TË NJOMË, NË FËMIJËRI, I KANË DHËNË RININË SPORTIT DHE E KANË MBYLLUR JETËN E TYRE PO ME SPORTIN".

thënë tmerrësisht saktë: "Në shoqërinë e ardhshme, personaliteti kryesor do të jetë mësuesi, jo gjenerali". Dhe ndofta se e kishte kuptuar kështu dhe para kohe, ai ndihej i barabartë me gjeneralët që nuk mungonin asnjëherë në mjediset dhe stadiumet tona, pasi ishte me të vërtetë një gjeneral pa spaleta në profesionin e tij fisnik. Sugjerimet dhe kërkesat e Bellovës, ata i merrnin përherë si të mirëqena, ndaj dhe e përkrahën atë pa rezerva si për sigurimin e bazës së nevojshme materiale, ashtu edhe për krijimin e terreneve sportive, aq sa te ne vinin e stërviteshin ekipet e para të "Partizanit" në futboll, basketboll, volejboll, atletikë, gjimnastikë, boks etj., ku natyrisht, kishin vendin dhe rolin e tyre edhe sportistët e shumë të skënderbegasve".

Ora e mësimin me Ismet Bellovën, pritej nga të gjithë me një gëzim të veçantë, pasi ajo më shumë se mësim, shndërrohej, me shpirtin e garës që ai nxiste, në spektakël, ku aktivizimi qe maksimal dhe përfitimi po ashtu.

Profesori, njëkohësisht jepte shumë informacione nga kultura e

tij e gjerë, deri edhe për zhvillimet dhe përparimet e sporteve në botë, pasi ai nga ana tjetër, ishte dhe komentatori zyrtar radiofonik dhe gazetari i pandarë i gazetës së mezi pritur "Sporti Popullor".

Edhe në shtëpi atë e konsiderojnë kryetar të familjes sportive, pasi nga të gjithë njihet fakti se bashkëshortja e tij Bukuroshja, kapitenia emblematike e kombëtares së basketbollit tonë, djemtë Sokoli dhe Enisi kanë studiuar në Institutin e Kulturës Fizike dhe së bashku me Edisonin, Arminin dhe me tri mbesat, pa bërë fjalë për vëllezërit e tij e më tej, janë përfaqësuar denjësisht në lloje të ndryshme sporti.

Ndjeshmëria e tij dhe nostalgjia që ka për mikrofonin e bëjnë që fjalët t'i dalin me një emocion fëmijor. Kujtimet e tij rrjedhin si në një film, ku nga fjala në fjalë gjen të papritura dhe të veçanta që mund t'i gjeshe vetëm në arkivat e RTSH-së. Ai është një arkiv më vete, në botën e bukur të sportit, në atë botë ku njeriu përjashton politikën, meritë, inatet dhe përfaqon relaksin shpirtëror që aq shumë na mungon ne shqiptarëve të rritur mes hallesh.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

"Historia e Ushtrisë Shqiptare", identitet, vlerë, trashëgimi e FA -së

Në kuadrin e 111-vjetorit të krijimit të FA-së, në sallën e Akademisë së Shkencave, në praninë e studiuesve dhe akademikëve të historisë së ushtrisë shqiptare nga ku zë fill historia e kombit shqiptar, u promovua libri "Historia e Ushtrisë Shqiptare", vëllimi I, 1912-1939, i përgatitur nga Prof. Dr. Proletar Hasani, Msc. Sali Onuzi, Prof. asc. Dr. Marenglen Kasmi, Dr. Asllan Zemani, Msc. Engjëllushe Sula, Prof. asc. Dr. Teki Kurti dhe Dr. Artur Meçollari.

Libri, thënë që në fillim, vjen më i plotë dhe i organizuar, në krahasim me vëllimin e parë të botuar në vitin 2000 nga Ministria e Mbrojtjes dhe që kishte për autorë: Prof. Dr. Proletar Hasanin, Dr. Asllan Zemani dhe Msc. Engjëllushe Sulajn.

Në vëllimin e parë është përshkruar vetëm organizimi i Ushtrisë Shqiptare, ndërsa në botimin e ri është pasuruar me një material më të plotë që kap të gjithë spektrin e ushtrisë. Vëllimi i parë nuk ishte i shoqëruar me foto dhe grafikë, ndërsa në vëllimin e ri ndeshim mjaft elemente të fotos, të skemave dhe të tabelave të ndryshme që e sjellin më të plotë dhe më të dukshme tërë veprimtarinë e ushtrisë të periudhës 1912-1939.

Së pari, vlera e librit qëndron në kriterin bazë që kanë ndjekur autorët, i cili është kriteri shkencor kronologjik, duke i dhënë gjithë librit vërtetësi dhe besueshmëri. Nëpërmjet kësaj vlere autorët në realizimin e misionit janë mbështetur dhe ballafaquar me një dokumentacion arkivor, kryesisht shqiptar, me fonde nga arkivat shqiptare dhe nga muzetë e vendit.

Puna kryesore e tyre është përqendruar dhe bazuar në AQSH, ku janë shfrytëzuar fonde të shumta, të cilat lidhen drejtpërdrejt me krijimin dhe organizimin e Ushtrisë Shqiptare dhe të FA-së në tërësi, në vitet 1912-1939. Fonde të shfrytëzuara gjerësisht janë veprimtaria e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, të Qeverisë së Princ V. Vidit, të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, të Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, të Këshillit Kombëtar, Këshillit të Naltë të Shtetit, etj.

Gjerësisht janë shfrytëzuar pjesa më e madhe e ligjeve dhe dekretligjeve për Ushtrinë dhe Fuqitë e Armatosura, të botuara në gazetata zyrtare të kohës.

Me vlera dokumentare origjinale në faqet e librit gjenden të përshkruara rregullore, botime, përkthime, etj., të cilat i kanë dhënë një panoramë në lidhje me Ushtrinë Shqiptare, me jetën, stërvitjen dhe veprimtarinë luftarake të saj, si dhe të mjaft personaliteteve ushtarake drejtuese të ushtrisë.

Njëkohësisht është vlerësuar dhe janë shfrytëzuar burime me vlera dokumentare, nga burime të huaja, botime dhe përmbledhje dokumente mbi Shqipërinë si nga ato angleze, austro-hungareze, franceze, italiane dhe turke, etj.

Vend dhe rol të rëndësishëm kanë zënë dhe botimet shkencore, letërsia historike, të cilat kanë trajtuar tematika ku përshkruhen ngjarje dhe protagonistë të historisë shqiptare, që kanë luajtur rol e kanë ndikuar në organizimin dhe zhvillimin e Ushtrisë Shqiptare. Botimet u përkasin viteve të ndryshme, gjatë 111 viteve të Ushtrisë Shqiptare.


Një burim tjetër i shfrytëzuar nga autorët është dhe shtypi periodik, ku përmes tij është sjellë mendimi intelektual dhe i opinionit shqiptar në lidhje me organizimin dhe evoluimin e Ushtrisë dhe të FA-së shqiptare në tërësi.

Autorët, duke qenë të kujdesshëm nuk kanë lënë jashtë vëmendjes dhe kujtime të personaliteteve politike dhe ushtarake të periudhës që përfshin libri. Në punën e autorëve mendoj se fotografitë kanë qenë një ndihmëse e çmuar, etj.

Së dyti, vlera qëndron në misionin e librit për evidentimin dhe publikimin në mënyrë sa më të plotë, të dokumentuar të përpjekjeve për të krijuar, për të organizuar dhe për të ndjekur periudhë pas periudhe ecurinë e zhvillimit dhe të përmirësimit të Ushtrisë Shqiptare.

Libri nuk trajton veprimtarinë luftarake të Ushtrisë, por thekson dhe evidenton detyrat kryesore të Ushtrisë Shqiptare në këtë periudhë. Autorët kanë përmendur luftime të zhvilluara në mbrojtje të territorit të vendit kundër pushtuesve të huaj, si dhe veprime për të nënshtruar lëvizjet kundër qeveritare në vend.

Libri analizon dukuri të aspekteve thelbësore që kanë të bëjnë



me krijimin dhe organizimin ushtarak shqiptar në përgjithësi, të Ushtrisë Shqiptare, gjatë periudhave të veprimtarisë, siç janë koha e lindjes, konceptet e organizimit, shpërbërjet, riorganizimet, reformimet, buxheti dhe mbështetja financiare, armatosja, pajisja, llojet e forcave, të armëve dhe shërbimeve, etj. Në libër trajtohen dhe dukuri të arsimimit, kualifikimit të oficerëve e të nënoficerëve, të disa specialiteteve etj. Vend të dukshëm zënë përpjekjet për ligjet në jetën ushtarake, stërvitjen dhe veprimtarinë e Ushtrisë dhe të ushtarakëve shqiptarë, përmes hartimit e publikimit të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Së treti, një vlerë e veçantë që ka gjetur në trajtim është dhe Xhandarmëria Shqiptare, e cila që në krijimin e saj përshfaqi veçori organizative. Xhandarmëria, në kohën e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, u përfshi në përbërje të Ushtrisë. Pranë Ministrisë së Luftës u ngrit zyra e posaçme, e emërtuar Komisioni i Trajtit të Xhandarmërisë dhe Policisë. Xhandarmëria kishte detyra mbrojtëse, si dhe të natyrës së ruajtjes së rendit e të sigurisë publike. Kjo ishte një dukuri e veçantë kur në kushtet shqiptare, ende nuk kishte Ushtria, kur vendi ishte në një situatë të vështirë kërcënimi për pushtim nga fqinjët Verior e Jugor. Në vitet 1914-1918 ky mision mbeti një detyrë e përhershme, krahas strukturave të Ushtrisë.

Qeveria shqiptare e konsideroi anëtarësimin në këtë organizatë si garanci për një trajtim më të drejtë të statusit dhe kufijve të Shqipërisë në tryezat vendimmarrëse të Fuqive të Mëdha, në një kohë shumë delikate pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Më 12 tetor, kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, Pandeli Evangjeli i drejtoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Eric Drummond në të cilën, në emër të popullit shqiptar, kërkoi që Shqipëria të pranohet anëtare në Lidhjen e Kombeve e të merrte pjesë në Asamblesë e madhe që do të hapet më 15 nëntor.

Perioda 12 tetor 1920 deri më 17 dhjetor 1920, kur Shqipëria u pranua si anëtare me të drejta të plota në Lidhjen e Kombeve, ishte e mbushur me një punë intensive diplomatike të qeverisë shqiptare dhe delegacioneve të saj në Paris e Gjenevë, dhe e mbështetur nga miq të Shqipërisë dhe shqiptarëve, ku spikat deputeti britanik Aubrey Herbert, etj. Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve me seli në Gjenevë, më 17 dhjetor 1920.

Anëtarësia në organizatën e Lidhjes së Kombeve shënon edhe fillimet e diplomacisë shumëpalëshe për shtetin shqiptar. Delegacioni shqiptar mbajti gjithmonë një qëndrim aktiv dhe progresist në këtë organizatë, e kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve kudo ku ato ndodheshin.

Organizata e Kombeve të Bashkuara

Pranimi i Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ka qenë një ndër problemet e rëndësishme të politikës së jashtme të shtetit shqiptar menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Që në mars 1945, qeveria shqiptare e kohës kishte kërkuar pranë Fuqive të Mëdha, iniciatore të krijimit të OKB-së, që Shqipëria të konsiderohej si anëtare themeluese e kësaj organizate për hir të pjesëmarrjes së popullit shqiptar në luftën e madhe antifashiste, si pjesë e koalicionit të madh antifashist të popujve.



Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Parë dhe të Dytë të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë

Qeveria e SHBA-së nuk e njohu qeverinë komuniste shqiptare që mori pushtetin pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Ajo i bëri të qartë qeverisë shqiptare se Fuqitë iniciatore të krijimit të kësaj organizate kishin rënë dakord të mos ftonin në konferencën e San Franciskos qeveritë që nuk ishin njohur akoma nga ato dhe me të cilat si pasojë nuk ishin vendosur marrëdhënie zyrtare, siç ishte rasti i Shqipërisë.

Kërkesat e qeverisë shqiptare për anëtarësim në këtë organizatë vazhduan pa ndërprerje, por edhe kushtet politike ndaj qeverisë shqiptare shtoheshin nga Uashingtoni e Londra. Situatën e rëndoi edhe i ashtuquajtur "Incidenti i Kanalit të Korfuzit", në marrëdhëniet me Britaninë e Madhe, si dhe prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë e Titos 1948, e cila e kishte mbështetur në fillim kërkesën e Shqipërisë. Në vitin 1954 Ministri i Jashtëm Behar Shtylla, i cili ishte edhe Observator Permanent i Shqipërisë pranë OKB-së, në kërkesën drejtuar Asamblesë së Përgjithshme në emër të qeverisë shqiptare, ndër të tjera shprehej se qeveria shqiptare pranonte pa asnjë rezervë të gjitha detyrimet që rridhnin nga Karta e OKB-së dhe se ishte e gatshme t'i plotësonte ato.

Ndërkohe shteti shqiptar filloi të zgjeronte numrin e shteteve me të cilat kishte vendosur marrëdhënie diplomatike, ishte forcuar miqësia me Bashkimin Sovjetik, anëtar i Këshillit

të Sigurimit, po bëheshin përpjekje për normalizimin e marrëdhënieve me Greqinë, Shqipëria ishte bërë pjesë në disa konventa ndërkombëtare apo organizata ndërkombëtare, ndër to edhe në organizata të specializuara të OKB-së si UNRRA etj.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e saj plenare të mbajtur më 14 dhjetor 1955, duke vepruar në bazë të rekomandimit të Këshillit të Sigurimit, mori në shqyrtim kërkesën e Shqipërisë dhe vendosi ta pranonte atë si anëtare të Kombeve të Bashkuara së bashku me 15 shtete të tjera.

Më 15 dhjetor u njoftua zyrtarisht qeveria shqiptare për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe tre ditë më pas u caktua delegacioni i saj zyrtar në sesionin e dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme.

Gjatë Luftës së Ftohtë dhe në logjikën e funksionimit të blloqeve politike, sesionet e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara në New York dhe takimet dypalëshe që zhvilloheshin atje ishin tepër të rëndësishme për diplomacinë shqiptare të kohës.

Shqipëria ka gëzuar pa ndërprerje statusin e shtetit anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në të mirë të paqes, mirëkuptimit dhe zgjidhjes së problemeve ndërkombëtare me mjete paqësore.



“Historia e Vërtetë e njerëzimit do të jetë e shkruar, vetëm kur ajo do të shkruhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve”

Për Shqipërinë dhe shqiptarët është shkruar edhe atëherë kur vendi dhe kombi ynë ende nuk njihet me këtë emër. Këta kanë qenë misionarë, diplomatë, historianë, udhëtarë etj., nga rajone të ndryshme të botës. Kanë mbajtur shënime ndërsa kanë kaluar në trojet tona. Të tjerë na kanë njohur nëpërmjet letërkëmbimeve apo dorëshkrimeve. Por, të gjitha këto, të shkruara në gjuhë të ndryshme të botës, në kohë dhe persona po të ndryshëm, për herë të parë na vijnë në gjuhën shqipe. Mendime kanë përcjellë shumë udhëtarë të huaj si: anglezë, irlandezë, gjermanë, austriakë, italianë, francezë, rumunë etj. Kronistë turq dhe turistë amerikanë, përshkruajnë me emocione bukurinë e veçantë të natyrës, dhe pasurinë shpirtërore të kombit tonë. Midis tyre gjen personalitete të shquara si: Koloneli Lik, Pokevili i famshëm, Aubrey Herbert, Lorenzoni e deri tek Perez De Kuelar. Poetë dhe artistë të mëdhenj si: Bajroni, Eduard Liri, Edit Durham etj. Vizitorë të shumtë, të cilët kanë vizituar trojet tona si: studiues, arkitektë, arkeologë, shkencëtarë, biologë, e deri dhe turistë ..., George Gordon Byron (Xhorxh Gordon Bajron) shkrimtar anglez i romantizmit dhe dashamirës i shqiptarëve.

“Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë peizazhin më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre...”, Bajroni.

Vizita në Shqipëri i la mbresa të thella Bajronit. Te shqiptarët ai pa një shpirt të veçantë, i cili ndezi imagjinatën e tij poetike për tema ekzotike. Në shënime të mbajtura, kur ishte në Shqipëri, për poemën Shtegtimi i Çajld Haroldit, ai shkruante për shqiptarët: “Më tërheqin shumë me atë ngjashmërinë e tyre me Hajlanderët e Skocisë, në veshje, në pamje dhe në mënyrën e jetesës”. Si kujtim ai mori një kostum tradicional shqiptar, me të cilin piktori Tomas Filips i ka bërë një portret. Ky kostum ka një histori më të gjatë. Ai aktualisht është i ekspozuar në Bowood Estates, Angli. Në përshkrimin e udhëtimeve të tij Bajroni thotë: “Në udhëtimet e mia kam mësuar të mendoj si filozof, dhe po të mos bëja ashtu, udhëtimi s’do të kish dobi”.

Bajroni i ka kushtuar 360 vargje Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre vargjeve del në pah njohja e Bajronit me historinë e Shqipërisë. Bajroni, ky ‘hero’ romantik, viziton Shqipërinë e Jugut dhe qëndroi si mik në sarajet e Ali Pashës, duke iu rezervuar një pritje me nder të mëdha. Nëpërmjet vargjeve ai përcjell: Emocionet për bukuritë e veçanta të natyrës sa magjepse, madhështore dhe e ashpër; Ali Pashën e vlerëson nga karakteri burrëror, dhe simbol i bujarisë së shqiptarëve, quan kryelartë e me një autoritet sovran; Shqiptaret i quante: “...njerëz të fortë, të ashpër, të pathyeshëm, sepse nëse ata nisen në luftë, sigurisht që kthehen me fitore...”; Vlerëson anën historike, madje himnizoi historinë shqiptare, sidomos Skënderbeun dhe kordhën e tij legjendare....

I pëlqeu pozicioni Gjeografik i Shqipërisë, sa arriti të himnizonte natyrën shqiptare (agimet dhe perëndimet e diellit, ditët me diell). U

dashurua me kulturën shqiptare, sidomos duke vlerësuar veshjet, zakonet, mitet etje., dhe sidomos këngët polifonike. U përfshi dhe emocionalisht sa dhe u motivua me Moralin dhe virtytet në një këndvështrim mjaft realist, më shumë vlerësonte vetitë e shqiptarit të thjeshtë, i cili ecte kryelartë në truallin stërgjyshor, duke spikatur mikpritja, bujaria, besa etj.

Edit Durham: “Paragjykimi mund të vijë nga padija apo mos njohja, në këto raste e vetmja rrugë për ta hequr atë, realizohet

vetë nga njohja konkretisht e realitetit”.

Edit Durham (Mary Edith Durham), udhëtare, artiste, shkrimtare dhe antropologe e dëgjuar britanike, e cila përshkroi jetën në trojet shqiptare.

Edit Durham, zonja britanike që u bë e famshme me shkrimet e saj për Shqipërinë dhe shqiptarët në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit XX. Mes shqiptarëve ajo gjeti pamjen e jetesës që ishte e mbushur me ndjenja kombëtare dhe atë të



lirisë. Ajo gjeti pritjen karakteristike të miqve shqiptarë, si dhe një shpirt ku ajo ndjente luftën e tyre për njohje ndërkombëtare. Ajo këto karakteristika i përcolli në çdo rast të komunikimit me të gjithë perëndimorët (anglezë e të tjerë), të cilët dinin shumë pak për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Pas botimit të librit të dytë “Refreni i Ballkanit” 1905, Edit Durham e vendosi shumë shpejt veten si autoritet i çështjeve shqiptare. Ajo pati sukses në udhëtimet e saj edhe pse u ndesh me terrene mjaft të ashpra, pengesa të qëllimshme të autoriteteve otomane, nuk u tremb nga përballja e mundshme e ndonjë pengmarrjeje nga ana kusarëve. Pavarësisht këtyre, ajo krijoi një reputacion të njerëzimit në vendet ku ajo shkeli. Me mendjen dhe sytë e saj si turiste dhe artiste, arriti të evidentonte disa opinione dhe t’iu bënte atyre komente mjaft entuziaste si: “Këtu është ngjyra, jeta dhe arti”.

Gjatë udhëtimit të parë për një kohë relativisht të gjatë në Shqipëri nga Jugu në Veri në vitin 1904, asaj i bëri përshtypje fakti që të gjitha shtresat e popullsisë nga do ku shkeli kërkonin pavarësinë e atdheut dhe njohjen angleze. Durhami nga kjo zbuloi një zë legjitim plot pasion sa dhe real, një e drejtë kjo që sipas saj s’mund t’ua mohonte askush... shqiptarëve!

Gjatë vitit 1908, atë e tërhoqën viset e Malësisë së Veriut të Shqipërisë. Në këtë kohë ajo e kishte transformuar veten në një etnografe dhe shprehte vendosmërinë në bërjen e studimeve serioze të fiseve shqiptare në trevat e Malësisë, dhe këtë e bëri realitet duke shkruar librin: “Shqipëria e Epërme” (1909). Ajo udhëtoi duke kaluar nga një fshat në tjetrin, e cila mori nderim madhështor. Për çdo fshat ajo evidentoi historitë dhe fotografoi nga afër çdo aspekt të jetës në fshatrat malore dhe arriti të grumbullonte një arkiv të pasur të traditave dhe zakoneve folklorike shqiptare. Gazetari britanik, Henri Nevinson, që e shoqëroi Durhamin, kur ajo administronte ndihmat për malësorët shqiptarë, gjatë luftërave ballkanike të 1911-1913, duke përshkruar cilësitë që e shndërruan atë në legjendë, thekson: “Qysh kur vuri këmbën në Shqipëri, ajo u bë shqiptare me zemër dhe shpirt”.

Më 1918 ajo u bë sekretarja e shoqatës Angli-Shqipëri e themeluar nga Aubrey Herbert në Londër dhe me anën e kësaj organizate kërkoheshin të drejtat e shqiptarëve. Përpjekjet e saj më pas konsistonin që Shqipëria të njëhej nga Lidhja e Kombeve më 1920. Ajo vazhdoi aktivitetin e saj edhe gjatë viteve 30-të, duke bërë shumë miq nga radhët e shqiptarëve, të cilët kishin mërguar në Londër. Ditën e 7 prillit të vitit 1939, kur ushtria fashiste italiane sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë, 76-vjeçarja doli në një rrugë të Londrës duke mbajtur në duar një pankarte ku shkruhej: “Larg duart nga Shqipëria!”.

Veprimtaria e Edith Durham për popullin shqiptar ka qenë madhështore dhe duhet të hulumtohet më tepër. Durhami dëshmon se fillimi i misionit të saj në mbështetje të çështjes së shqiptarëve që kaq i mbarë falë ungjillorëve, sepse nuk dihet se si Durhami do të mund të udhëtonte ndryshe, aq gjatë e gjerë në gjithë territorin shqiptar, sikur të mos i ofrohej një dorë nga shqiptarët e ndershëm.

Shqiptarët e nderojnë akoma edhe sot Editin dhe kanë respekt për të. Ajo sipas shqiptarëve është “Mbretëresha e Malësorëve”. Ajo u mirëprit nga malësorët shqiptarë dhe gjatë kalimit të saj në këto vise nuk pati asnjë keqtrajtim edhe pse ishte një femër e vetme. Përshtypje të mbetura nga Shqipëria ishte tradita e “Burneshave Shqiptare”, që ishte një zakon ku femrat visheshin si burra dhe kishin një pozitë të qartë në shoqëri. Mbas vdekjes së saj në 1944, Mbreti Zog i Shqipërisë i dha merita të larta asaj. Mbreti Zog ka shkruar për të: “Ajo na fali neve zemrën e saj dhe fitoi si këmbim vëmendjen e malësorëve tanë”. Ajo vazhdon të nderohet si “Heroinë Kombëtare” dhe në 2004 në një deklaratë, presidentit shqiptar, Alfred Moisiu e cilësoi atë si një nga figurat më të spikatura të Shqipërisë të shekullit të kaluar.

Kushdo që e njohu nga afër popullin shqiptar shprehu për të gjithë afeksionin që ky vend delegon tek vizitorët e tij.

Nikolla Jorga: “Populli shqiptar së bashku me baskët, janë më të vjetërit në Evropë”.

Maximilian Lambertz: “Historia e Vërtetë e njerëzimit do të jetë e shkruar, vetëm kur ajo do të shkruhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve”.

Lamartini: “Ky komb e ky popull nuk merret nëpër këmbë... Kjo është toka e heronjve të të gjithë kohërave...Homeri aty gjeti Akilin, grekët Aleksandrin e Madh, turqit Skënderbeun, njerëz këta të së njëjtës racë, të të njëjtit gjak”.

M. Huacunthe Hecquard: “Në asnjë vend të botës femrat nuk janë më të respektuara dhe nuk ushtrojnë një veprimtari më të fuqishme se shqiptaret dhe disa nëna shqiptare kanë përzënë prej shtëpisë bijtë e vet pasi ata ishin larguar nga fronti i luftës. Ato i kishin kthyer në fushën e betejës”.

Lord Bajroni: “Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë peizazhin më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e

bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre”.

Henry Noel Brailsford: “...Shqiptari ‘primitiv’, në fakt është ‘Mbinjeriu’ për të cilin Nietzsche ëndërronte”.

Giuseppe Katapangu: “Atlantida, e cila është zhdukur para 12.000 vjetësh, ishte tokë e Ilirëve (pellazgëve), të cilët shpëtuan nga përmytja e Atlantidës dhe filluan civilizimet e reja në të gjitha kontinentet, sidomos në Evropë, Afrikë dhe Azi të vogël!”

Agostino Ribeco: “Të drejtat mijëvjeçare të shqiptarëve, etnografike dhe gjeografike, shtrihen prej kohërave të vjetra në Iliri, Maqedoni dhe Thesali”.

Braislav Nusic: “Shqiptarët janë autoktonë, të cilët gjatë të gjitha dyndjeve të popujve, e ruajtën tipin dhe karakterin e vet në mënyrë të theksuar. Ata u bënë ballë sulmeve të romakëve, mësymjeve të dendura të sllavëve, të cilët ua pushtuan të gjitha fushat, ultësirat, dhe lumenjtë”.

Dushko H. Konstantinov: “Shqiptarët janë banorët më të vjetër të Gadishullit Ballkanik dhe pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve të vjetër, të cilët kishin ndërtaur shtetin më të fuqishëm në Ballkan”.

Edvin Jacques: “Ilirët ose shqiptarët, këta bijë të paepur, ishin luftëtarë të shqipes, trashëgimtarë të denjë të Akilit, Filipit, Aleksandrit të Madh dhe Piros së Epirit...”.

Edvin Pears: “Shqiptarët janë pasardhës të racës më të vjetër



të Gadishullit Ballkanik, gjegjësisht të racës ariane, duke e nxjerrë këtë fjalë nga dy rrënjët e fjalëve shqipe: Ar dhe Anë, që d.m.th., ‘njerëz të arit të pastër’”.

Maks Myle: “Emrat e mjaft popujve të njohur rrjedhin nga fjalë e vjetër shqipe ‘Ar’. Kjo vlen edhe për mjaft vende të botës.”

Fanulla Papazogllu: “Dardania është njëra nga krahinat antike të Ballkanit ku popullata autoktone është ruajtur më së miri”.

Gos Xhen: “Origjina e shqiptarëve arrin deri te koha e pellazgëve dhe kanë origjinë para-helene”.

Gustav Majer: “Shqiptarët janë Ilir të rinj”.

Gjorgj Hahni: “Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve, ndërsa ilirët janë pasardhës të pellazgëve...Shqiptarët janë stërnipërit e Pellazgëve”.

Haki Pasha: “Po doli në shesh historia e shqiptarëve, Perandorinë Osmane e merr lumi”.

Harold Whitehal: “Hieroglifet egjiptiane, të krijuara para 4.000 vjetësh kanë domethënie shqipe”.

Henri Braisford: “Në Maqedoni, vetëm shqiptarët janë popull autokton”

Johan Fon Han: “Shqipja rrjedh nga ilirishtja dhe ilirishtja

nga pellazgjishtja”.

Jovan Cvijiq: “Sllavët e jugut, pas ardhjes në Ballkan, aty gjetën shqiptarët, të cilët nën tryshninë e tyre (sllavëve) u tërhoqën drejt jugut dhe në vendet më malore, ku i hasim edhe sot”.

Konstandin Papparigopulos: “Vetëm shqiptaret konsiderohen si pasardhës të racës ilire”.

Mikpritja, besa, mbajtja e fjalës së dhënë, janë disa nga vlerat më pozitive dhe tiparet më dalluese, me të cilat i karakterizojnë të huajt, shqiptarët.

Historia e popullit shqiptar, e fokusuar që nga kohët më të lashta e deri në ditët e sotme, vazhdimisht ka ngjallur dhe vazhdon të ngjallë ende interesin e shumë studiueseve, historianëve, publicistëve dhe albanologëve të huaj, të cilët herë pas here kanë botuar libra voluminoze me studime me mjaft vlera, duke pasqyruar me vërtetësi të kaluarën e Kombit shqiptar dhe rolin që ai ka luajtur në zhvillimet Ballkanike dhe Evropiane, si në planin politik ashtu dhe atë historik.

Patriotizmi, i cili është ndër ndjenjat më të theksuara e më të ngulitura te karakteri i shqiptarëve. Këtë e kanë vënë re jo vetëm studiuesit e lartpërmendur, por të gjithë studiuesit. Interesant është fakti se shqiptarët i ka bashkuar identiteti kombëtar shumë më herët se mjaft kombe evropiane. Shqiptarët në mbrojtje të atdheut,

patriotizmin e tyre e përforcojnë dhe me respektimin e lidhjeve vëllazërore, që i bënë një e të pa ndarë dhe si rrjedhojë ata shfaqin realisht atë që janë: besnikërinë, respektimin e fjalës së dhënë dhe mbrojtjen e të vërtetës dhe të drejtës deri dhe me sakrificë supreme. Këto vlera morale manifestohen dhe me njerëzimit të tjerë që i bashkohen kauzave madhore, të personalitetit, karakterit dhe çështjeve atdhetare.

Levenderia, “kursimi i armikut të mundur”. Në kohët e lashta e tillë është quajtur kjo ndjenjë, Levenderi. Ajo tregon më së miri ndjenjën e krenarisë, fisnikërisë dhe burrisë të shqiptarëve. Duke pasur parasysh këtë element, çdokush mund të konstatojë se shqiptarët nuk janë barbarë, ashtu siç janë përpjekur disa pseudo historianë t’i paraqesin.

“Gruaja është e paprekshme”. Ky është një parim i lashtë i shqiptarëve dhe vazhdon edhe në ditët e sotme, ndonëse jo si më parë. Në Shqipëri femra është e respektuar. Këtë e dëshmojnë fakte si mbretërimi i mbretëreshës Teuta më fronin ilir apo dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili është cilësuar barbar, porse femrën e cilëson të paprekshme.

Kjo është Shqipëria jonë, ky vend i vogël me histori të rrallë.




Mundësit ushtarakë të Forcave të Armatosura shqiptare, afër medaljes së bronzit në botërorin e Azerbajxhanit

Në Baku, Azerbajxhan u zhvillua Kampionati i 36-të Botëror Ushtarak i Mundjes për meshkuj dhe femra. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ekipi shqiptar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë, me trajner Major Zylfi Shehun dhe mundësit, nëntoger Oltjan Bardhi, kategoria e peshës 57 kg, stili i Lirë, rreshter Klodjan Koçi, kategoria e peshës 130 kg, stili Greko - Romak dhe Ushtar II Marjan Kola, i kategorisë së peshës 87 kg, stili Greko - Romak. Më shumë se 230 sportistë të shteteve të ndryshme të botës morën pjesë në këtë aktivitet.

Mundësit tanë zhvilluan ndeshje të forta, ku dhe arritën të futeshin në garën për medalje bronz (vendi 3 - 5). U-II Marjan Kola, pas ndeshjeve fituese, u kualifikua më tej për t'u ndeshur me nën kampionin e botës dhe kampionin e Evropës në kategorinë 87 kg, ku mundësi i ekipit tonë U-II Marjan Kola zuri vendin e 5-të në botë, duke zhvilluar ndeshje të nivelit të lartë dhe duke marrë edhe duartrokitjet e publikut. Gjithashtu edhe mundësit e kategorisë 57 kg u renditën i 7-ti dhe ai 130 kg u rendit i 8-ti në peshën e tij, çka përbën një lajm të mirë dhe premtues për të ardhmen e sportit të mundjes në Forcat e Armatosura.

Synimi i trajnerit Major Zylfi Shehu ka qenë zona e medaljeve, ai shprehet se tashmë kemi krijuar një ekip cilësor dhe premtues për të ardhmen, objektivi kryesor për garat e ardhshme ndërkombëtare do të jetë marrja e medaljeve individuale si dhe do të synohet edhe për rezultat ekipor. Të rinjtë dhe të rejtat që do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura do të kenë mundësinë që të bëhen pjesë e ekipit të sporteve ndeshës. Risi e veçante do të jetë edhe përfshirja për herë të parë e femrave në ekipin e mundjes.

Trajneri,
Major Zylfi Shehu





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Rinia antifashiste e fshatit Vajzë

(Në kuadër të 80-vjetorit dhe në kujtim të Delo Mystehak Sulçaj (10.6.1929-30.11.1943), dëshmorit 14-vjeçar, të ekzekutuar nga fashizmi gjerman se ishte pjesë e rinisë antifashiste të fshatit Vajzë, familje me rrënjë e degë të lidhura fort me formacionet partizane të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; rinia antifashiste e fshatit Vajzë ishte një kontribuuese me vlerë në lirinë e Shqipërisë).

Janë me qindra dëshmorë e heronj shqiptar në monumente e lapidarë. Dëshmorët e heronjtë nuk rrojnë në mermer të akullt, por në radhë të parë jetojnë në zemrën e ngrohtë e të përjetshme të popullit, jetojnë në fisnikërinë e tij.

Vajza e historisë, fshati i Labërisë, i lashtësisë kaonike, i qytetërimit amant, i burrave të fortë si shkëmbi, i luftëtarëve e kapedanëve të lirisë, në barrikadë të parë në rreshtat kundërshtuese të pushtimeve nëpër shekuj, fshati i kapedanit e prijësit Hito Zenel Hitaj, por dhe trimave e luftëtarëve të mëdhenj të luftërave për liri e pavarësi, fshati-bazë nisje nga Beuni, për luftën e Vlorës të epopesë së madhe të 1920-tës, por që u bë edhe fshat martir antifashist kundër fashistëve italianë e gjermanë. Djemtë e Labërisë ndoshta një shumicë nuk e njihnin historinë e luftërave të shqiptarëve të lexuar në historikë, biblioteka e arkiva, por njihnin fort bëmat e trimëritë e të parëve nga këngët e trashëgimia gojore e pasur. Ata ndoshta nuk kishin dijeni, për Herodotin, Tukididin, Polibin, Tit Livin, Plinin e ri, Plinin plak, Strabonin, Hans Delbrück-un, Sun Tzu-në, Marcus Tullius Cicero, Henri Zhomein, Karl Fon Klauseviç-in etj, (përfshito këtu një pakicë djemsh të shkolluar), por përtej filozofëve, historianëve të luftërave, gjeografëve e gjeneralëve botërorë, njihnin mirë artin e të luftuarit shekujve, për racën arbërore, racë që nuk e theu gjurin, para asnjë pushtuesi. Kështu erdhi rinia e fshatit Vajzë dhe e gjithë Labërisë deri në prag të 7 prillit 1939, ditën e pushtimit nga fashizmi italian. Duke i dalë zot vatani çeta rrëmbu armët dhe doli në mbrojtje në Skelë dhe Bestrovë të Vlorës, sikurse ishte nga të parat fshatra që ngriti njësit gueril dhe çetë partizane të fshatit.

Në Historikun e fshatit Vajzë të shkruar nga një komision me 17 anëtarë në vitet 1970-1980, si dhe të riformuar, rishkruar e ripublikuar nga një komision prej 13 anëtarësh, në vitin 2023, me rastin e 79-vjetorit të çlirimit të atdheut, në mënyrë të unifikuar shkruhet se: Rinia antifashiste e fshatit Vajzë ka qenë pjesë e gjithë formacioneve antifashiste të fshatit, krahinës e më gjerë. Ndërsa për Delo Sulçajn, të pushkatuar nga trupat gjermane në moshën 14-vjeçare, dhe që është në proces të hartimit të dokumentacionit, për shpallje dëshmor shkruhet: “Delo Mystehak Sulçaj, djali i Këze Shahin Sulçaj dhe vëllai i dëshmorit Mete Sulçaj; ishte fare i ri në moshë, akoma nuk i kishte mbushur të 14 vjetët, kur në një natë nëntori të vitit 1943, u kap nga gjermanët dhe u pushkatua në afërsi të Buzës së Bletës. Ai mbajti qëndrim prej burri përpara xhelatëve fashistë e bashkëpunëtorëve të tyre ballistë, dhe nuk tregoi asnjë nga bazat partizane, as shokët e fshatarët se ku ndodheshin (sipas origjinalit të “Historiku i fshatit Vajzë”, të botimit të dytë, Vajzë 1980, faqe 140-141). Në historik, kur i referohet “Të rinjtë e fshatit Vajzë”, gjejmë të shkruhet: “Edhe të rinjtë e fshatit Vajzë nuk qëndruan prapa, ata u treguan trima e të vendosur, mbushën radhët e çetës partizane të fshatit dhe të çetave të tjera të rregullta, ata ishin agjitorë të zjarrtë për çështjen e luftës kundër fashizmit italian e gjerman, punuan pa u lodhur me rininë antifashiste të fshatit dhe luftuan me trimëri dhe shumë prej tyre dhanë edhe jetën për çlirimin e Shqipërisë”. Të rinjtë e fshatit Vajzë që ranë në luftë për çlirimin e Atdheut me armë në dorë kundër okupatorit fashist e bashkëpunëtorëve të fashizmit janë: Sheremet Çerçiz Çaushaj, Mete Mystehak Sulçaj, Faik Ormen Shakaj, Qendro Sadush Bellaj, Lelo Hadër Habilaj, Maliq Hadër Habilaj, Haxhi Hate Deraj, Xhepo Xhevit Shakaj, Isa Zagoll Veselaj. Pjesa tjetër e të rinjve, shumica e të cilëve u rreshtuan në radhët e çetave partizane e më vonë në batalionet dhe brigadat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, si dhe disa prej tyre ushtuan një aktivitet të mirë në terren gjatë gjithë kohës së luftës ishin: Pirro Rexhep Hoxhaj, Vojsava Hitaj, Donika Hitaj, Çize Bellaj, Marika Brahimaj, Tafil Sadushaj, Malo Alem Nazaj, Bino Kasaj, Xhevdet Kasaj, Remzi Begë Hanaj, Selfo Ferhati, Reshat Zagoll Bilbilaj, Maliq Sadushaj, Fuat Çerçiz Çaushaj, Hysen Brahimaj, Shamet Hanaj, Reiz Ali Brahaj etj. Aktiviteti patriotik e luftarak i popullit të Vajzës është një vepër monumentale që tregon qëndrësë, burrëri, guxim, trimëri dhe besim të patundur në fitoren përfundimtare mbi okupatorët dhe bashkëpunëtorët e tyre. Ndërkohë që të rinj të tjerë antifashistë që janë ekzekutuar nga italianët e gjermanët janë në një moshë fare të re sikurse kanë qenë nëntë të ekzekutuar në fshatin Vajzë sikurse ka qenë edhe Delo Sulçaj, Ferik Zagoll Bilbilaj, etj.

Gjaku i 22 dëshmorëve të LANÇ-it, tashmë të shpallur Dëshmorë të Atdheut, meriton të nderohet bashkë me gjakun e 10 të rënëve të tjerë për lirinë: Delo Mystehak Sulçaj, Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Këze Shahin Sulçaj, Pesare Xhezo Kërroçaj, Beqir Hasho Osmani, Abdyl Hasho Osmani, Shaho Barjam Selimaj, Sadedin Sherif Hazizi, Azbi Nurçe Hitaj.

Fshati Vajzë, fshati i Ali Asllan poetit e ka larë me gjak lirinë. Kështu në fakt nuk ka 22 dëshmorë lufte të luftës antifashiste, që gjenden në lapidar, sikurse janë: Perlat Rexhepi (hero dhe dëshmor), Sadik Karafil, Rexhep Shakaj, Teki Hanaj, Lelo Hadër Habilaj, Maliq Hadër Habilaj, Isa Veselaj, Mete Sulçaj, Qendro Bellaj, Mustafa Bellaj, Fehta Resulaj, Gani Resulaj, Faik Shakaj, Haxhi Deraj, Fehti Bora, Axhem Veselaj, Hasan Zenelaj, Zihni Rexhepi, Jetulla Kapaj, Refat Kacaj, Jonus Karemani dhe Sheremet Çaushaj. Por në fakt ka dhe duhet të shkruhen në lapidar 32 dëshmorë të Atdheut, pasi edhe të pushkatuarit janë dëshmorë në bazë të kriterëve të Ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, pika d), shtetasit shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrje në formacionet



luftarake Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945. Që të gjithë të rënë në frontin e luftës Çlirimtare por edhe ata që janë pushkatuar e sakrifiku për lirinë e Shqipërisë meriton titullin e lartë “dëshmor”.

Cili ishte Delo Mystehak Sulçaj, i cili ka hyrë në epopenë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare si “pioneri-dëshmor” i fshatit Vajzë? Delo Sulçaj (10.6.1929 - 30.11.1943), ishte i biri i Mystehak Sulçaj nga Vajza e Vlorës dhe Këze Shahin Sulçaj me origjinë nga Beçishti i Tepelenës, (edhe nëna e tij është ekzekutuar nga fashizmi), por ishte edhe vëllai i dëshmorit Mete Sulçaj nga Vajza e Vlorës. Delua ishte lindur në Vajzë të Vlorës më 10 qershor 1929, kur vendi ynë ishte në regjim monarkik.

Delo Sulçaj, erdhi në jetë në një familje me tradita patriotike, luftarake e atdhetare. Delo Sulçaj, ishte burrëruar dhe bërë “djali për pushkë”, siç quhej në Labëri për djemtë që u kishte “djersitur mustaqaja”. Familja e tij ishte e varfër, por e ndershme dhe gëzonte respekt në mbarë fshatin e krahinën. Njihet e transmetohet në breza qëndrimi i tij para përpara pushtimit që faktikisht ishte qëndrim i një heroi lufte, që nuk ju drodh qerpiku para ekzekutimit fashist. Delo Sulçaj u rrit në kushte të vështira ekonomike. Babai i vdiq shpejt, në vitin 1936, duke e lënë fare të vogël, në moshën 7 vjeçare. Delua me vëllezërit e tij u detyruan të punojnë hyzmeqar tek bejlerët e Vlorës për të siguruar bukën e gojës. Vëllai i tij më i madh Gani Sulçaj, herë i burgosur nga regjimi mbretëror e herë i arratisur, nuk mund të siguronte jetesën për familjen për të ardhura. Familja e Delos u lidh shpejt dhe tërësisht me luftën, duke venë në shërbim të saj gjithçka; shtëpinë, njerëzit dhe atë pak pasuri dhe mbi të gjitha zemrat e tyre. Vëllezërit e tij Ganiu dhe Metja dolën partizanë, nëna e tij me Delon bënin shërbime të tjera si bazë e luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Ai si një i ri antifashist, u dallua për aktivitet në shërbim të luftës çlirimtare, kryente detyra korrieri, shoqërua i partizanëve nga njëra bazë në tjetrën etj. Gjatë operacionit të 30 nëntorit 1943 dhe pikërisht ditën e teksa po zbriste nga mali i Beunit, bashkëpunëtorët e fashistëve ishin fshehur dhe diktuan zbritjen nga mali të një djali energjik por të vetmuar. Kështu Delo Sulçaj si pjesë e familjes të lidhur fuqishëm me luftën partizane e kapin në befasi tek mullinjët e Vajzës. Sapo zbriti në rrugë dhe kur po kalonte drejt përroit u kap dhe u dorëzua gjermanëve menjëherë. Duke marrë informacion se kush ishte dhe çfarë familje përfaqësonte, nazistët gjermanët e pushkatuan po atë ditë afër vendit që quhet “Buza e Bletës” në Vajzë. I riu guximtar, 14-vjeçari Delo Sulçaj, nuk u përkul e as iu nënshtua nazistëve gjermanë edhe para pushtimit duke e mbyllur jetën e tij fare të re me nder e dinjitet, si një i ri patriot antifashist i vendosur. Ai jeton përjetësisht në memorie të kombit, por që meriton të shpallet me emrin e ndritur “Dëshmor”, titull që e kanë merituar prej kohësh, bazuar në kriteret e ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, Delo Sulçaj, ra në fushën e nderit dhe ngeli i pavdekshëm,

në memorien e fshatit Vajzë si dëshmor edhe pse statusi i dëshmorit vonoi juridikisht. Delua ishte vëllai i vogël i Ganiut (Sulçaj-Vajza) dhe Metes (Sulçaj-Vajza), mjaft të njohur për aktivitetin patriotike e luftarak jo vetëm në çetën e fshatit Vajzë. Mete Sulçaj ra dëshmor i LANÇ-it, ndërsa Gani (Sulçaj-Vajza) ka qenë atdhetar, luftëtar partizan, burrë shteti i shquar i Ushtrisë; që edhe pse i gjymtuar që në luftë shkroi një faqe të ndritur historie, burrërie e ndershmërie në shërbim të Atdheut.

Nëse depërtojmë në historikun e fshatit Vajzë gjejmë, se “Vëllai i madh i Delos, Gani Vajza (Sulçaj) ka qenë një ndër figurat e shquara të luftës antifashiste, komunist i vitit 1942, nga të parët në fshatin Vajzë. Delua ndoqi shembullin e vëllait të madh Ganiut. Gani Vajza, me gjithë familjen e tij, me dy vëllezërit më të vegjël, Sefer Sulçaj, Mete Sulçaj si dhe me njerëzit Këze Shahin Sulçaj, Delo Sulçaj (që u ekzekutua nga pushtuesi), ai edhe me kushërinin e tij Tahir Elmazin (Sulçaj) u hodhën pa rezerva në luftën e madhe antifashiste, duke dhënë kontributin e tyre si familje dhe ai si individ. Gani Mystehaku Sulçaj u shqua për trimëri e guxim në luftë kundër okupatorit fashist dhe tradhtarëve të vendit. Në një nga luftimet ai u plagos rëndë, duke humbur dorën e majtë dhe ngeli përjetë i gjymtuar fizikisht, me zemër të fortë atdhetare dhe besnik i idealeve të çlirimit. Por edhe pse mbeti me një dorë, ai luftoi dhe u dallua në çdo betejë, si partizan dhe antifashist. Ganiu ishte gjithmonë i pari në sulm. Ai nuk merrte parasysh asnjë lloj sakrifice. Luftoi me urretje të pakufishme për armikun dhe ushqente një dashuri të zjarrtë për popullin dhe për Atdheun. Gani Mystehaku Sulçaj edhe pas luftës, duke shërbyer në ushtri si oficer në nivele të larta, si edhe në organet e punëve të brendshme, kreu me nder e plot sukses detyrat e ngarkuara si komandant reparti e njësie. Kolonel Gani Vajza ka ngelur në kujtesën e një plejade të gjerë ushtarakësh dhe që e kanë njohur kur ka punuar në Divizionin e Mbrojtjes së Popullit në Shkodër, në shumë zona të saj, Komandant i Kufirit në Peshkopi, Komandant i Repartit Ushtarak nr.84 (Brig. Ndjekjes) Tepelenë, Drejtor në Ministrinë e Brendshme si dhe detyra të tjera në strukturat e sigurisë së shtetit dhe të burgjeve, që ngelet një figurë elitare e burrërore që i bënte nder çdo lloj detyre, një autoritet i padiskutueshëm dhe një shtetar dinjitoz e krenar veprimtarinë në luftë dhe në punë. Ai kurdoherë zbatoi me besnikëri e atdhdashuri gjithë detyrat që iu ngarkuan, si dhe gjithmonë ka qenë vigjilent dhe i gatshëm për të kryer çdo mision e përgjegjësi shtetërore. Gani Vajza - Sulçaj, si bir i popullit të Vajzës, si luftëtar për çështjen e madhe të Shqipërisë, mbeti si një figurë e shquar dhe shumë e dashur ndër bashkëfshatarët e tij dhe të bashkëluftëtarëve të lirisë, që ka pasur djalin Ëngjëllin, i cili ka humbur jetën në një aksident dhe dy fëmijë të tjerë, Gjonin dhe Luizën. Gani Vajza është një ndër partizanët që luftoi me një dorë sepe ishte plagosur në betejën në Radhimë, kur ishte në çetën Plakë, sikurse edhe Çobo Shakaj, që ishte babai i DSh Kol. Eqerem Çobo Shakaj, (për momentin i strehuar në një shtëpi të moshuarish, në Kavajë; si i pa strehë), komisar Ago Çeli i batalionit “Asim Zeneli” dhe Elmaz Teme, (ish-Sek. Parë në Tepelenë; që e dërguan dhe kryetar kooperative në Dukaj). Pleqësia e fshatit Vajzë në bashkëpunim edhe me Shoqatën Kulturorë Atdhetare “Vajza”, me Kryesinë e Organizatës së Dëshmorëve dega e Selenicës por edhe në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Historianëve ushtarakë shqiptarë, e ka evidentuar si një ndër të rënë gjatë LANÇ-it, që plotëson plotësisht kriteret sipas ligjit për t’u shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut”, sepse ia preu jetën në mes pushkatimi i nazifashistëve gjermanë.

Historiografia shqiptare do t’i kujtojë gjithmonë trimat dhe ata që ranë për Atdhe, që gjakun e derdhën pa kursim. Të rënë janë përjetësuar dhe trupëzuar me idealat e përjetshme të vetë kombit, prandaj edhe kujtohet Delo Mystehak Sulçaj në tetëdhjetë vjetorin e rënies së tij.

Në aspektin juridik, kompetenca që i jep ligji institucioneve të shtetit shqiptar, Prefektit në të pesë pikat e “nenit 11-Komisionet vendore”, ligji nr. 109/2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, mundëson propozimin për Delo Mystehak Sulçaj për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” në Komisionin Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i ngritur pranë Ministrisë së Mbrojtjes, që besohet se është vetëm çështje kohe. Edhe pse jeta e tij ishte e shkurtër kontributi për çlirim nuk harrohet brez pas brezi dhe gjaku i bijve të fshatit Vajzë meriton nderim e homazh si dhe lartësim në piedestalet e lirisë së kombit. Nderimi për bijtë e lirisë sikurse është edhe Delo Sulçaj është nderim që nuk është i mjaftueshëm vetëm të nderohet në një ditë sikurse është nderimi në ditën e Dëshmorëve të Kombit, më 5 Maj, datë e pamjaftueshme për t’u nderuar gjaku i të rënëve, as vetëm ceremoniale qendrore shtetërore me protokoll shtetëror, që bëjnë nderimet ceremoniale zyrtare tek kryeqendra e memorialëve dhe kujtesës së kombit për dëshmorët, në kompleksin e “Varrezave të Dëshmorëve të Kombit” tek monumenti “Nëna Shqipëri”. Nderimi i të rënëve bëhet edhe më i ngrohtë dhe më mesazh-përcjellës tek familjet, organizatat, tek rinia, tek fshati ku lindi dhe u ekzekutua barbarisht dëshmori pionier Delo Sulçaj. Nderimi për të rënë ka qenë dhe do të ngelet nderim e vlerësim për identitetin e shqiptarizms.

Kontaktoni

NUMRAT E REKRUTIMIT NEPER RRETHE



SHKODËR
068 233 4681

KUKËS
068 209 8572

DIBËR
068 336 6108

LEZHË
067 580 0466

DURRËS
069 290 0055

TIRANË
068 672 1576

ELBASAN
068 806 6385

FIER
069 224 1289

BERAT
069 253 4025

KORÇË
0673762747

GJIROKASTËR
0697352024

VLORË
069 253 6102

